



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Kosovës
Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 22. 04. 2008
Ndërtesa e Kuvendit, ora 10:00, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Enis Kervan, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci dhe Radmila Vujović.

Munguan: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ardian Gjini dhe Ramadan Avdiu.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit, me këtë

RENDITE

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
2. Marrëdhëniet me Unionin Interparlamentar në Gjenevë
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

U miratua procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Marrëdhëniet me Unionin Interparlamentar në Gjenevë

Sabri Hamiti - Lidhur me iniciativën për anëtarësim në Unionin Ndërparlamentar, tha se do të na informojë deputeti Ibrahim Gashi.

Ibrahim Gashi - Tha, si anëtar i grupit të punës për hartimin e prioriteteve të punës së Komisionit për këtë vit, kam bërë disa kontakte me Unionin Ndërparlamentar me seli në Gjenevë, pastaj me liberalët e Parlamentit Suedez dhe së fundi me një grup diplomatësh të Spanjës që janë të akredituar në Bullgari dhe në Maqedoni. Po ashtu e kemi iniciuar mundësinë e një bashkëpunimi ndërparlamentar me Senatin e Spanjës. Nga këto nisma tha se konkrete është iniciativa për marrëdhëniet e Parlamentit të Kosovës me Unionin Ndërparlamentar me seli në Gjenevë.

Fillimisht propozohet që nismën ta miratojë Kryetari i Kuvendit të Kosovës me një letër dhe pastaj të pasojë një vizitë e tre anëtarëve të Kryesisë dhe një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Unionit Ndërparlamentar, për të nisur bisedimet për format e anëtarësimit të Kuvendit të Kosovës në këtë Union. Kjo që ne po bisedojmë sot, është vetëm nismë për ta marrë aprovimin e Kryetarit dhe të Komisionit, ndoshta edhe të Kryesisë për të lëvizur në këtë drejtim.

Në vazhdim tha se edhe Kryetari i Kuvendit është i njoftuar për këtë nismë dhe të njëjtin material ia kam dërguar edhe atij për historikun e Unionit dhe për rëndësinë që do të kishte ky anëtarësim.

Sabri Hamiti - Tha se kërkesa që të krijojmë raporte me parlamente të tjera është e paraparë edhe në programin e Kryesisë dhe të këtij Komisioni. Mendoj se është e natyrshme kjo mënyrë e inicimit dhe ne do të vazhdojmë me këto iniciativa edhe me parlamente të tjera. Do ta provojmë edhe mënyrën e komunikimit me Parlamentin Evropian dhe me institucionet e tjera parlamentare.

Përkrah këtë iniciativë, që kjo t'i përcillet si nismë Kryetarit të Kuvendit që ai ta shkruajë një letër që është e domosdoshme për fillimin e procedurave dhe për anëtarësim.

Nexhat Daci - Tha se në këto rrethana, në të cilat gjendemi, nismat e këtilla gjithnjë janë të mirëseardhura, në veçanti për lobimin ose për përkrahjen e Kuvendit në institucione ndërkombëtare. Kjo nismë duhet të përshëndetet dhe t'i përkrahim kryetarin dhe instancat që e vlerësojnë dhe merren me këtë. E mbështesë këtë iniciativë.

Xhavit Haliti - Tha se ky mekanizëm e krijon mundësinë e organizimit të bashkëpunimit ndërmjet parlamenteve dhe në veçanti angazhohet në mbrojtjen e të drejtave të deputetëve. Në vazhdim tha se ne, duke u futur në këtë mekanizëm, mund ta kemi një grupim shtesë që do të llojë për interesat e Kosovës dhe në veçanti për interesat e Kuvendit të Kosovës. E mbështes këtë iniciativë dhe mendoj se askush nuk do të jetë kundër, duke përfshirë edhe Kryetarin e Kuvendit.

Eqrem Kryeziu - Tha se e përkrah këtë iniciativë.

Sabri Hamiti - Propozoi që të kërkohet nga Kryetari i Kuvendit që ta shkruajë një letër inicuese dhe ta dërgojë në adresën e udhëheqësisë së Unionit Ndërparlamentar

Komisioni pas këtyre diskutimeve nxori këtë

P e r f u n d i m

I. Të iniciohet procedura për anëtarësimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Unionin Ndërparlamentar në Gjenevë.

II. T'i propozohet kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës ta miratojë iniciativën e Komisionit

për punë të jashtme për fillimin e procedurës së anëtarësimin të Kuvendit të Kosovës në Unionin Ndërparlamentar me seli në Gjenevë.

3. Të ndryshme

Xhavit Haliti - Tha se nuk jemi të informuar mjaft si qëndron e vërteta me ngadalësimin e njohjes së shtetit të Kosovës nga ana e shteteve të tjera, në veçanti nga shtetet e Lindjes së Mesme. Në këtë drejtim shtoi se, do të duhej të ndërmerrej nisma konkrete nga Kuvendi, nga Komisioni dhe nga Kryesia e Kuvendit, të vihet kontakti, jo vetëm për lobim, por edhe me kërkesë që këto shtete ta njohin pavarësinë e Kosovës. Propozoi të bëhen përpjekje për kontakte, me anë të një vizite në Emiratet e Bashkuara dhe në disa shtete të tjera, t'i sugjerohet Qeverisë ose ne të ndërmarrim hapa në këtë drejtim.

Në fund tha se për menaxhimin e këtij procesi, Komisioni, Kryesia e Kuvendit dhe në përgjithësi Kuvendi, nuk e ka një asistencë të kualifikuar mirë, për të cilën duhet të bisedohet në Kryesi.

Sabri Hamiti – Tha, pajtohem me propozimin e deputetit Xh. Halitit, se kontaktet janë të nevojshme, ndërsa infrastruktura dhe përgatitja mungojnë në të gjitha nivelet.

Në vazhdim tha se duhet të merremi vesh me Qeverinë, të përcaktohet çka mund të bëjmë lidhur me vendet islamike, nga të cilat kemi ngecje. Mendon se është mirë të krijohet një ekip jo i madh dhe t'i frekuentojë pikat themelore të këtyre vendeve. Kjo mund të bëhet me një koordinim ndërmjet kryetarit të Kuvendit dhe të Qeverisë. Nganjëherë Kuvendi mund t'i vërë kontaktet më lehtë se Qeveria, sepse kontaktet parlamentare janë më të lira.

Ibrahim Gashi - Tha, pajtohem me diskutimet e parafolësve për koordinim me Qeverinë. Gjithsesi ajo pjesë e botës ka nevojë të preket dhe mekanizmi më i mirë është diplomacia parlamentare.

Kjo nuk pret kohë derisa ta krijojmë stafin profesional dhe është mirë të lëvizim në këtë drejtim, sepse kemi ngecje në procesin e njohjes. Shumëkush ka pritur që njohja nga vendet e fuqishme të pasohet edhe nga 50 shtetet e vendeve islamike. Në fund tha se grupi i punës, që kemi, mund t'ia fillojë nismës së këtyre kontakteve dhe të marrë përsipër, në koordinim me ju, të lëvizim në këtë drejtim derisa ta kemi një asistent të kualifikuar që mund t'i kryejë këto punë për ne.

Nexhat Daci - Tha mendoj se gjithkund në botë pozita është e fuqishme atëherë kur opozita është e inkuadruar në proceset e shtetit. Shkuarja në një vend tjetër e kryeministrit ose e kryeparlamentarit, kur e ka opozitën me vete, nuk ia dobëson rolin askujt, përkundrazi e fuqizon atë. Sa i përket diplomacisë parlamentare tha se, në rastet kritike, pas asaj të sportit dhe të ekonomisë është më e fuqishme se Qeveria. Në fund shtoi se është gabim i madh nëse i ndajmë shtetet në të mëdha dhe në të vogla, në të rëndësishme dhe në të parëndësishme, sepse ne në lëkurën tonë e kemi përjetua këtë ndarje, të rendit të parë dhe të rendit të dytë. Në këtë drejtim nuk duhet të ngurrojmë as për vendet e ish-bllokut sovjetik.

Eqrem Kryeziu – Tha, është mirë që t'i bashkërendojmë punët me Qeverinë për një bashkëpunim intensiv për këtë çështje. Mendoj se në proceset politike krahas pozitës duhet të jetë e kyçur edhe opozita.

Enis Kervan - Mendon se patjetër, si Komision ose si Kuvend, duhet të jemi në kontakt me Qeverinë lidhur me aktivitetet politike. E njoftoi Komisionin se para dy-tre ditësh, Kryeministri i Turqisë, që

gjithnjë flet në emër të Qeverisë, e ka dhënë një deklaratë se deri në fund do të llobojnë me shtetet islamike për njohjen e Republikës së Kosovës. Mendon se obligimet duhet të ndahen si për Qeverinë ashtu edhe për Kuvendin.

Sabri Hamiti - Tha se këto aktivitete diplomatike të kësaj natyre kërkojnë veprim të përsheptuar, të organizuar në kuptimin material, organizues dhe koordinues. Lidhur me këtë, tha se ne, mund ta kontaktojmë Qeverinë, ta shtrojmë problemin hapur se çka dëshirojmë, çka mendojmë se na mungon dhe çka mund të bëjmë, duke e pasur parasysh se jemi në dispozicion të gjithë, pa marr parasysh pozitë ose opozitë, që në vendin e caktuar të jemi më të fuqishëm.

Xhavit Haliti – E njoftoi Komisionin se javën e kaluar ka qenë në Bullgari dhe e ka përfaqësuar Kuvendin e Kosovës në Konferencën Rajonale, ku merrnin pjesë delegacionet e të gjitha shteteve të rajonit. Në vazhdim tha se e ka bërë një ekspozitë të Kuvendit të Kosovës dhe ka biseduar me zëvendëskryetarin e Parlamentit të Rumanisë për ta njohja e pavarësisë së Kosovës është kaq e vështirë. Kësaj pyetjeje tha se i janë përgjigjur, se presidenti i Rumanisë është shumë kundër dhe para zgjedhjeve nuk mund të ketë njohje të pavarësisë së Kosovës.

Në fund shtoi se Konferenca ka zgjatur dy ditë dhe përkundër përpjekjeve të tri vendeve, që Kosova të mos e merrte fjalën në këtë Konferencë, kryetari i Parlamentit të Bullgarisë nuk iu nënshtrua presionit dhe ma dha fjalën.

Mbledhja përfundoi në orën 10,40 min.

Kryetari i Komisionit
Sabri Hamiti

Procesmbajtësi
Minire Hasani